



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo


Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Drejtoria Arsimit

Kamenicë

Nr. 280, datë 07.07.2026



Bazuar në nenin 5, shkronja b) të Ligjit nr.03/L-068 për Arsim në Komunat e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.08/L-153 për edukimin në fëmijërinë e hershme, neni 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë, Drejtoria e Arsimit shpall:

KONKURS

Për regjistrimin e fëmijëve në Institucionin Parashkollor “Filizat” në Kamenicë dhe Koretin për vitin shkollor 2026/2027

Vendet e lira në Institucionet parashkollore 2026-2027			
	IP “FILIZAT”		
Grup-Mosha	KAMENICË	KORETIN	Gjithsej
0-> 2vjeç	12	12	24
2->3 vjeç	3	16	19
3->4 vjeç	0	22	22
4->5vjeç	0	24	24
Gjithsej	15	74	89

Kushtet dhe dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Formulari i aplikimit (merret në IP "Filizat" Kamenicë);
2. Dokumenti personal i prindit (kujdestarit ligjor);
3. Ekstrakti i lindjes së fëmijës;
4. Faturë të shërbimeve komunale jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj;
5. Vërtetim mbi marrëdhënien e punës për të dy prindërit (kujdestarit ligjor)
6. Pasqyra e Trustit për 6-mujorin e fundit;
7. Vërtetim i vaksinimit të fëmijës;
8. Dëshmi mjekësore për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të fëmijës;
9. Çertifikata e vendbanimit (fëmijët me vendbanim në Dajkoc, Muçivërc, Rogaçicë, Hodonovc, Topanicë dhe Petroc të drejtën e aplikimit e kanë vetëm për Institucionin Parashkollor në Koretin, të përcaktuar sipas sipas zonës së mbulimit);
10. Nënshkrimi i prindit/ kujdestarit ligjor;
11. Numri i fëmijëve tjerë të vendosur në IP "Filiza.

Afati i aplikimit:

- Konkursi mbetet i hapur nga data **08.07.2026** deri më **23.07.2026**.
- Formularët për aplikim dhe dorëzim të dokumenteve bëhet në
- Institucioni Parashkollor "Filizat" – Kamenicë, cdo ditë pune prej orës 08:00 deri 16:00;
- Të gjitha dokumentet e pakompletuara jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në konkurs nuk shqyrtohen.



Selami Klaiqi

Drejtor i Arsimit